

## NË EMËR TË POPULLIT

*Pas mbajtjes së seancës orale, publike fillestare të datës 18.10.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë:*

### A K T G J Y K I M

*I akuzuari E. B. nga babai A. dhe nëna Sh., e lindur A., i lindur më datë ... në Gj. me vendbanim të përhershëm në fsh D. K.R. , i papunë, i pamartuar, e ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar shtetas i R.së Kosovës ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale dhe më parë.*

### Është fajtor S e p s e

*Gjatë muajit Mars të vitit 2016, në kohë të papërcaktuar, në Gjilan, i pandehuri E. B., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, e ka kanosur të dëmtuarën S. D., se do ti zbulojë foto që do ta dëmtojnë nderin dhe autoritetin e saj, në atë mënyrë që përmes SMS në viber nga nr. ..., i dërgon foto me plumb në dorë, dhe në rrjetin social FCB me mbishkrimin "Ky plumb të pret ty dhe familjen tuaj ke kohë dy ditë", ku vazhdimisht i pandehuri ka kërkuar të holla në shumë prej 5000 euro nga e dëmtuara duke i thënë se "krejt fotot e tua desh ja qes në internet dhe thuaj babës ton mos të gabon me më kërcënua dhe ska me të lan kurrë me u feju e me u martua tjetër kund i qon 5000 euro dhe nuk të pengoj më" se në rast se nuk e përmbush këtë kërkesë, të njëjtës do t'ia publikojnë të gjitha fotot në rrjetin social.*

*-me çka ka kryer veprën penale shantazhi, nga neni 341 par.1 të KPRK-së,*

*Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore dhe të neneve 4,7,17,21,41,45,47,73,75,80 e 83 të KPRK-së si dhe të neneve 365,463 e 451 të KPPRK-së atij i shqipton:*

### DËNIM KUMULATIV ME BURGIM DHE ME GJOBË

*Ashtu që të akuzuarit E. B. i caktohet dënimi me gjobe prej 150 (njqindpeseshjete)Euro dhe burgim në kohëzgjatje prej 60 ( gjashtëdhjetë ) ditëve, ashtu që me pwlqimin e te njëjtit i zëvendësohet në dënim me gjobë konform nenit 47 të KPRK-së edhe ate në shumën prej 800 (tetqind) Eurove, të cilin ai duhet ta paguaj në afatin 30 ditor pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë,e nëse ai ate nuk e paguan-ai do ti shëndrrohet në dënim me burgim prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve.*

*Koha e kaluar ne ndalim policor dhe ajo ne paraburgim nga data ... e deri me datën ..., do ti llogaritet ne dënimin e shqiptuar ... dite x ... Euro = ... Euro .*

*Pala e dëmtuar S. D. nga Gj., për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontestin civil.*

*I akuzuari obligohet që në emër të paushalli gjyqësor të paguaj **20 (njëzet) Euro** si dhe në emër të hargjimeve të procedurës penale, si dhe shumën e përlllogaritur me llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate , të gjitha këto në afatin 15 ditor, por që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.*

*Komunikimi përfundoi me dt.18.10.2016, ne ora 9.30 minuta, ne praninë palëve procedurale, ku i akuzuari përmes avokatit te tij Begzad Hajrullahu, kërkoi qe dënimi me burgim ti zëvendësohet me dënim me gjobe, qka edhe u aprovua nga gjytari.*

*Vertetojne,*

*Sek.juridike,*

*Gjyqtari,*

### *A r s y e t i m*

*Prokuroria Themelore në Gjilan e ka ngritur aktakuzën e saj me shkrim PP.II.nr.1778/2016 të datës 14.10.2016 ndaj të akuzuarit E. B.nga fsh.D. K.R. , për shkak të veprës penale shantazhi nga neni 341 par.1 të KPRK-së.*

*Në seancën fillestare gjyqësore të mbajtur më 18.10.2016 përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Prokurori i Shtetit Shefik Memeti , gjatë fjalës së tij përfundimtare,po shpreh tjerash pohoi se në tërësi mbetem pranë aktakuzës së lartcekur me shkrim,duke I propozuar gjykatës që të akuzuarin E. B., ta shpall fajtor dhe ta dënoj me denim meritor sipas ligjit, i cili denim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale si dhe pasojat e shkaktuar të të dëmtuarës, andaj me rastin e matjes së dënimit kërkoj nga gjykata ti ketë paqrasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.*

*I akuzuari E. B.nga fsh.D. K.R. në fjalën e tij përfundimtare ,e pranoi fajsinë veprën për të cilën më vihet në barrë duke kërkuar që të njejtit ti shqiptohet një denim sa më I butë dhe premtimin se më nuk do ta përsëris at vepër .Poashtu edhe avokati I tij mbrojtës B. H. ,propozoi qe klientit te tij te I shqiptohet nje denim sa me I butë dhe ti keni parasysh të gjitha rrethanat e vecanërsiht ato lehtësuese duke patur parasysh faktin se i njëjti është penduar thellësisht dhe i vjen keq për të dëmtuarën dhe është i gatsheëm për ti kërkuar falje. Gjatë zhvillimit të procedurës është sjellur korrekt dhe është treguar bashkëpunues gjatë zhvillimit të procedurës dhe se asnjëherë nuk ka qenë më parë i dënuar.*

*Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart,gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike,*

*Se I akuzuari E. B., me dashje e ka kryer veprën penale shantazh neni 327 par.lnenpar.1.1 të KPRK-së,në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin E. B.,për shkak të kryerjes së veprës së lartcekur penale,ngase veprimet e të njejtit I përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës.*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe te lartësisë se denimeve, gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat nga neni 73 dhe 75 te KPRK-es, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se I akuzari pati sjellje te shkelqyra ne seancat gjyqësore, I moshes se re, I pa punë, me gjendje te rendë ekonomike dhe ne kohen e kryerjes se vepres ishte shume I ri, e si rrethanë rënduese pasojat e shkaktuara te demtuarve.*

*Sipas bindjes se lire të kësaj gjykate, caktimi I dënimit komulativ me burgim dhe gjobë ndaj te akuzaurit E., është marrë duke I pasur për bazë te githa rrethanat e lartëcekura, është denim I drejtë, ne harmoni me peshën e vepres penale dhe shkallen e përgjegjësisë se te akuzuarit, si dhe me kete denim komulativ do të mund të arrihet qellimi I dënimit nga neni 41 I KPRK-ës. Poashtu beri zbutjen e dënimit nen minimumin e parapare ligjor per at veper penale nga shkaqet e cekura nje pasus me larte.*

*Vendimi mbi kerkesën pasurore juridike është I bazuar ne nenin 463 të KPPRK-ës.*

*Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit, është I bazuar ne nenin 83 te KPRK-se, ndersa mbi shqiptimin e denimit unik, ne nenin 80 te KPRK-se.*

*Vendimi mbi paushallin gjyqësor dhe harxhimet e procedures penale është bazuar ne nenin 451 te KPPRK-ës.*

*Duke u bazuar nga te cekurat me lartë është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.1223/16 më datë 18.10.2016**

**Sekretare juridike**  
**Vjollca Dërmaku**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*

